



ANEKS KONTRATA

Në mes të

Date: 23.09.2020

Komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejme Autoriteti Kontraktues)

Dhe

Konsorciumi "Muhamer Hasani B.I (N.T.P "Elektro Meli & Graniti")" adresa Podujevë përfaqësuar nga Muhamer Hasani, me numër të regjistrimit të biznesit 810782898 dhe "Niti – N" Sh.P.K, adresa Prishtinë përfaqësuar nga Naim Zymeri në tekstin e mëtejme ("Kontraktuesi"), janë pajtuar të lidhin këtë Aneks kontrate

Duke pasur parasysh se palët kontraktuese të përmendura më lartë kanë lidhur kontratë mbi kryerjen e punëve për: Ndërtimi i ndriçimit publik, Ilot II me nr. të prokurimit 615-20-520-5-2-1, nr i brendshëm 61520011521 të datës: 16.06.2020, e cila kontratë është në realizim e sipër

- i. Duke u bazuar në kërkesën për punë shtesë nga menaxheri i projektit dhe arsyetimet për mospërfshirjen e punëve shtesë në kontratën bazë, në njoftimin për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, në vendimin mbi aprovimin e punëve shtesë të kontratës dhe kryerjen e suksesshme të punëve për Ndërtimi i ndriçimit publik, Ilot II – punë shtesë, Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi pajtohen që të lidhin aneks kontratë për kryerjen e punëve shtesë sipas ofertës së datës 17.09.20120 me kushte të njëjta si në kontratën bazë.

ME KËTË U PAJTUAN SI VIJON:

1. Kontrata bazë që është duke u përmbushur, është vazhduar edhe për kryerjen e punëve shtesë të pa parashikuara si marrëveshje reciproke në mes palëve.
2. Çmimi i punëve shtesë është gjithsej: 2,915.55 €
(dymijëenëntëqindpesëmbëdhjetëeuro pesëdhjetëpesëcent sipas përshkrimeve të punëve dhe sasive të dhëna në Dosjen e tenderit nr. [61520011521/5].
3. Punët shtesë kontraktohen bazuar në përshkrimin e punëve shtesë të Menaxherëve të Projektit, Njoftimit në KRPP dhe kushteve të negociuara në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit që janë pjesë e këtij Aneksi të Kontratës.
4. Pagesa e punëve shtesë do të bëhet në bazë të konstatimit të Personave të Autorizuar të Autoritetit Kontraktues pas perfundimit të punëve.
5. Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
 - a. Marrëveshja e kontratës;
 - b. Përshkrimi i punëve shtesë nga Menaxherët e projektit që duhet të realizohen;
 - c. Njoftimi në KRPP për punët shtesë.
6. Të gjitha kushtet tjera të kontratës bazë mbesin të njëjta.

Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin

Për Autoritetin Kontraktuesin		Për Kontraktuesin	
Emri:	Rasim Fejza	Emri:	Muhamer Hasani
Pozita:	menaxher i prokurimit	Pozita:	Drejtore
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	23.09.2020	Data:	23.09.2020
Vula:		Vula:	